



BASHKIMI
EVROPIAN I
SQARUAR

Energjia

Energji e
qëndrueshme,
e sigurt dhe e
përballueshme
për evropianët

Garantimi i energjisë së sigurt me çmime të përballueshme është një nga sfidat më të mëdha me të cilën BE-ja po përballlet aktualisht: integrimi i mëtejshëm i politikave evropiane të energjisë dhe të folurit njëzëri në skenën globale është vendimtar drejt suksesit.



BASHKIMI EVROPIAN I SQARUAR

Ky publikim është pjesë e serisë që sqaron punën e BE-së në fusha të ndryshme të politikave, pse është e përfshirë BE-ja dhe cilat janë rezultatet.

Publikimet mund t'i gjeni këtu:

http://europa.eu/pol/index_en.htm

<http://europa.eu/!bY34KD>

Si funksionon BE-ja
Evropa në 12 leksione
Evropa 2020: Strategjia e Evropës për Zhvillim
Themeluesit e BE-së

Bujqësia
Bankat dhe Financat
Kufijtë dhe Siguria
Buxheti
Veprimi Klimatik
Konkurrenca
Konsumatorët
Kultura dhe politika audio vizuele
Dogana
Agjenda digjitale
Unioni ekonomik, monetar dhe euro
Arsimi, trajnimi, rinia dhe sporti
Punësimi dhe çështjet sociale
Energjia ✘
Zgjerimi
Ndërmarrjet
Mjedisi
Lufta kundër mashtrimit
Siguria e ushqimit
Çështjet e jashtme dhe politika e sigurisë Ndhima humanitare dhe mbrojtja civile
Tregu i brendshëm
Bashkëpunimi dhe zhvillimi ndërkombëtar
Drejtësia, shtetësia, të drejtat fundamentale
Çështjet detare dhe peshkataria
Migrimi dhe azili
Shëndeti publik
Politika rajonale
Hulumtimi dhe Inovacioni
Tatimi
Tregtia
Transporti

PËRMBAJTA

Interesat e përbashkëta në një fushë strategjike.....3

Çfarë hapash ndërmerr Evropa për t'u përgatitur?
Strategjia evropiane e energjisë5

Çfarë bën BE-ja?
Fuqizimi i konsumatorëve dhe stimulimi i sektorit të energjisë9

Puna e filluar
2020 dhe më pas:
ndërtimi i një Bashkimi të Energjisë ... 14

Lexim plotësues..... 16

Bashkimi Evropian i sqaruar: Energjia

Komisioni Evropian
Drejtoria e Përgjithshme për Komunikim
Informimi i qytetarëve
1049 Bruksel
BELGJIKË

Doracaku u azhurnua në nëntor 2014

Ballina dhe fotografia në faqen 2:
© Digital Vision/Getty Images

16 pp. — 21 × 29.7 cm
ISBN 978-92-9238-359-6
doi:10.2871/547738

Luksemburg: Zyra e Publikimeve e
Bashkimit Evropian, 2016

© Bashkimi Evropian, 2016
Riprodhimi është i autorizuar. Për çdo përdorim ose riprodhim të fotografive, duhet të kërkohet leje drejtpërdrejt nga autori.

Pse na nevojitet një politikë evropiane e energjisë?

Interesat e përbashkëta në një fushë strategjike

Ndriçimi, ngrohja, transporti, prodhimi industrial: pa energji nuk do ta kishim asnjërin nga këto shërbime të përditshme themelore, pa të cilat ne dhe bizneset tona nuk mund të funksionojmë. Mirëpo, rezervat tona të lëndëve djegëse fosile (nafta, gazi dhe thëngjilli), nuk do të zgjasin përgjithmonë. Ato duhet të menaxhohen në mënyrë të drejtë, ndërkohë që ne kërkojmë burime të reja të energjisë. Evropa konsumon dhe importon sasi gjithnjë e më të mëdha të energjisë. Vendet e BE-së janë të vetëdijshme për përparësitë e veprimit të koordinuar në një fushë kaq strategjike. Kjo ka sjellë si rrjedhojë rregullat e përbashkëta në të gjithë Evropën dhe bashkimin e përpjekjeve të Evropës për të siguruar energjinë e nevojshme me çmim të përbalueshëm, duke gjeneruar sasi minimale të ndotjes.

Një sektor i ndërlikuar

Pavarësisht nga fakti se veprimeve si: ndezja e kompjuterit apo e makinës nuk ua dijmë vlerën, ato janë faza e fundit e një procesi të ndërlikuar. Para së




Gjenerimi i energjisë dhe transportimi i tij tek konsumatorët kërkon burime të mëdha teknike, logjistike dhe financiare.

gjithash, resurset energjetike, siç janë: gazi, nafta dhe thëngjilli, duhet të nxirren nga toka. Druri gjithashtu mund të shndërrohet në ngrohje dhe energjia elektrike mund të prodhohet nga era, uji dhe rrezet e diellit me anë të turbinave të erës, digave dhe paneleve diellore. Kjo energji pastaj, duhet të transportohet, ndonjëherë edhe përtej kontinenteve ose nën det, deri në vendin ku do të përdoret. Për këtë duhen centrale elektrike që mund të garantojnë furnizim të pandërprerë të energjisë për shumë dekada. Këtu përfshihen resurse masive teknike, logjistike dhe financiare.

Energjia është një sektor strategjik, meqenëse nuk mund t'ia dalim pa të. Është me rëndësi jetike për ndriçimin, mbrojtjen nga të ftohtit dhe transportin e njerëzve dhemallrave, si dhe për të mbështetur të gjithë sektorët e ekonomisë — bujqësinë, industrinë dhe shërbimet — si dhe progresin shkencor. Standardi ynë jetësor kërkon sasi të mëdha të energjisë dhe kjo pa dyshim shkakton ndotjen (e ajrit, ujit, tokës dhe klimës), ndikimi i së cilës duhet të zvogëlohet sa më shumë që të jetë e mundur.

IMPORTET E LËNËDËVE DJEGËSE FOSILE, EU- 27 (1995-2012)



(*) Includes lignite.

(**) Includes oil products.

Burimi: Eurostat, prill 2013.

Importuesi më i madh botëror

Evropa varet në aspektin energjetik nga e gjithë bota. Bashkimi Evropian, ekonomia e dytë më e madhe në botë, konsumon një të pestën e energjisë botërore, mirëpo ka shumë pak rezerva të veta. Për fat të mirë, këtu në Evropë, portofoli - i njohur si 'përzjerje e energjisë' — është i shumëllojshëm: nga digat e shumta të Austrisë, minierat e thëngjillit në Poloni ose centralet e energjisë bërthamore në Francë, e deri në pajisjet për nxjerrjen e naftës në Detin e Veriut dhe fushat e gazit në Holandë e Danimarkë. Asnjë nga vendet e Evropës nuk janë të ngjashme, dhe kjo nuk është një disavantazh-natyrisht, me kusht që këto vende të punojnë së bashku për të shfrytëzuar maksimumin e shumëllojshmërisë së tyre.

Varësia energjetike e Evropës ka ndikim mjaft të madh në ekonominë tonë. Ne e blejmë naftën nga OPEC-u (Organizata e Vendeve që Eksportojnë Naftë) dhe Rusia, kurse gazin nga Rusia, Norvegjia dhe Algjeria. Arkat e Evropës varfërohen për një shumë prej afro 350 miliardë eurosh çdo vjet për të paguar këto. Kostot e energjisë gjithashtu vazhdojnë të rriten. Kjo nuk lë shumë mundësi për të zgjedhur: shtetet e BE-së duhet të jenë efektive, të caktojë qëllime ambicioze dhe të punojnë së bashku, nëse dëshirojnë të diversifikojnë burimet e veta të energjisë dhe kanalet e tyre të furnizimit.

Kufizimet klimatike

Ekspertët kryesorë kanë treguar koston jashtëzakonisht të madhe të ndryshimit të klimës, nëse bota nuk fillon menjëherë të zvogëlojë emetimet e veta të gazrave serrë. Sektori energjetik është i përfshirë në mënyrë direkte pasi që mbi 80% e prodhimit të tij vjen nga lëndët djegëse fosile, të cilat, kur digjen emetojnë CO₂ dhe gazin serrë kryesor. Prandaj, në të ardhmen, sektori energjetik i Evropës do të duhet të zvogëlojë lëndët djegëse dhe të përdorë shumë më tepër burime të energjisë me nivel të ulët të karbonit.

Evropa duhet të veprojë së bashku

Rëndësia që vendet e BE-së ia kushtojnë sektorit të energjisë, nuk është asgjë e re. Relevanca e saj u njoh menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, kur, sipas fjalëve të Jean Monnet, një nga themeluesit e BE-së, u vendos që 'instrumentet e luftës të vendosen në shërbim të paqes'. Thëngjilli dhe çeliku, si dhe energjia bërthamore ishin pikënisja për traktatet e para evropiane: Komuniteti Evropian për Thëngjill dhe Çelik (ECSC), i cili u inkorporua në politikat e BE-së vitin 2002, dhe Traktati Euratom mbi energjinë bërthamore, i cili është ende në fuqi.

Në vitet 1960, vendet e BE-së kuptuan se duhet të punojnë bashkë për të zgjidhur problemet e furnizimit me energji. Si rezultat i kësaj, ato i grumbulluan rezervat strategjike të naftës dhe themeluan një procedurë të menaxhimit të krizës. Tani, politika e energjisë ka gjithashtu ndikim në shumë fusha të tjera: industri, mjedis, transport, hulumtim dhe inovacion, madje edhe marrëdhënie të jashtme.

Qëllimet e Evropës

Bashkimi Evropian ka fuqinë dhe instrumentet që i duhen për të implementuar një politikë energjetike të orientuar drejt:

- sigurimit të furnizimeve energjetike të Evropës;
- sigurimit që çmimet e energjisë nuk e bëjnë Evropën më pak konkurruese;
- mbrojtjes së mjedisit dhe sidomos luftimit të ndryshimeve klimatike;
- përmirësimit të rrjeteve të energjisë.

Vendet e BE-së janë të lira të zhvillojnë cilatdo burime të energjisë që duan. Megjithatë, duhet të marrin parasysh objektivat e energjisë së ripërtitshme të BE-së.

Tregu i vetëm i gjysmë miliardë evropianëve..



Si vepron BE-ja?

Një strategji evropiane të energjisë

Meqë Evropa ka pak rezerva të energjisë, aktualisht duhet të importojë më shumë se gjysmën e energjisë së vet. Pasi që çmimi vendoset nga tregjet botërore, Evropa nuk ka zgjedhje tjetër, pos të paguajë këtë çmim. Mënyra më e mirë për zvogëlimin e faturës së energjisë është të zvogëlohet sasia e energjisë që shpenzohet. Kjo mund të duket e qartë. Mirëpo, a mund të shpenzohet më pak, ndërkohë që ta ruajmë standardin tonë të jetës dhe komoditetit modern?

Kursimi i energjisë

Edhe pse nuk është çështje e lehtë, përgjigja është po: duke përdorur energjinë në mënyrë më të mirë dhe më efektive. Një zgjidhje e dobishme në aspekt të dyfishtë: emetimi i CO₂-së mund të parandalohet, ne bëhemi më pak të varur nga importet e energjisë dhe mund të krijohen mundësi për vende të reja pune dhe kursime të parasë. Për më tepër kemi mundësinë të eksportojmë ekspertizën tonë. Prandaj, eficientia e energjisë është një nga objektivat kryesore të Bashkimit Evropian për vitin 2020. Liderët evropian vendosën që konsumi i përgjithshëm i nevojshëm i energjisë duhet të zvogëlohet për 20%, nërmjet viteve 1990-2020. Ky zvogëlim i dukshëm do të ishte i barazvlefshëm me mbylljen e prodhimit të më se 400 elektranave. Për të arritur objektivin e tij, Bashkimi Evropian duhet t'i inkurajojë vendet e veta anëtarë të ndërpresin shpenzimin e panevojshëm të energjisë nga aparatet elektrike, industria dhe transporti. Objektet janë

gjithashtu fushë kryesore, pasi që ne konsumojmë 40% të energjisë, teksa ato lirojnë 36% të të gjitha gazrave serrë në BE, 80% në formë të ngrohjes.

Direktiva për eficienten e energjisë, e miratuar në vitin 2012, do t'i ndihmojë BE-së për të arritur këto caqe dhe të përfitojë nga të gjitha mundësitë e eficientës së energjisë. Ky është një ligj ndërsektorial që fut masa në të gjithë sektorët e mëdhenj ekonomik, duke përfshirë caqe të reja të energjisë dhe auditime, rikuperimin e energjisë dhe objektivat e performancës së energjisë. Më 2014, Komisioni Evropian do të vlerësojë nëse BE-ja është në rrugën e duhur për të arritur cakun prej 20% dhe të sugjerojë një rrugë të nevojshme përpara.

Të gjitha vendet e BE-së, është dashur të përcaktojnë caqet indikative kombëtare të eficientës së energjisë për vitin 2020 dhe të hartojnë plane duke theksuar se si synojnë t'i arrijnë ato. Duke pasur parasysh klimën e vështirë ekonomike, BE-ja duhet t'i heq të gjitha ndalesat kur bëhet fjalë për nxitjen e investimeve dhe veprimeve konkrete në fushën e eficientës së energjisë. Edhe në qoftë se investimet në eficienten e energjisë bëhen shpejt fitimprurëse dhe veprojnë si një shtytës për investime të mëtejme, paratë duhet të jenë në dispozicion në rend të parë. Bashkimi Evropian mund të ndihmojë anëtarët e vet t'i financojnë planet e tyre të eficientës së energjisë nga buxheti dhe institucionet e veta financiare. Një shumë e konsiderueshme e fondeve të BE-së është në dispozicion gjatë periudhës 2014-



Sfida për evropianët: ulja e konsumit duke ruajtur standardin e jetesës.

2020 për të ndihmuar rritjen e investimeve në efikasitetin e energjisë (23 miliardë € vetëm nga Fondet Strukturore të BE-së). Për më tepër, efikasiteti i energjisë po bëhet një fushë e rëndësishme për kërkime dhe inovacion nën programin “Horizon 2020” (shih më poshtë).

Një treg i mirëfilltë evropian i energjisë

Në parim, energjia elektrike dhe gasi mund të rrjedhin lirshëm nëpër rrjetet që shkojnë kryq e tërthor Evropës. Në një treg të vetëm evropian të energjisë, të gjithë prodhuesit dhe furnizuesit konkurrojnë me njëri tjetrin. Prandaj, teoretikisht është e mundur që të blihet dhe shitet energjia elektrike dhe gasi kudo që ju dëshironi, duke pasur si qëllim marrjen e energjisë me cilësi të lartë dhe me çmim më të përshtatshëm. Megjithatë, ky treg me 500 milionë konsumatorë ende nuk është bërë realitet, meqë zhvillimi i bizneseve ndërkufitare të energjisë ende është duke hasur në pengesa nga një tërësi e rregullave nacionale. Çmimet e gazit dhe energjisë elektrike për bizneset, të caktuara nga qeveritë, janë vetëm një shembull. Disa aktorë, madje, kanë një qasje të padrejtë të privilegjuar në rrjetet e energjisë. Kështu, investitorët janë duke u larguar sepse e ardhmja nuk është shumë premtuese. Efekti i rezultatit të pashmangshëm indirekt i kësaj, mund të jetë vonimi i rindërtimit të centraleve elektrike që janë vjetruar shumë. Në këtë mënyrë, konkurrenca duhet të menaxhohet në mënyrë më të mirë dhe të prezantohen rregullat e përbashkëta për shfrytëzimin e barabartë të rrjeteve. Bashkimi Evropian këtu ka një rol vendimtar, meqenëse, nëse i cakton rregullat, ka gjithashtu kompetenca të gjera të mbikëqyrë tregjet, për të parandaluar aktorët e caktuar të shfrytëzojnë padrejtësisht çdo lloj monopoli.

Rrjetet moderne të energjisë

Rrjetet e energjisë, gjithashtu duhet të modernizohen dhe të zhvillohen për të përballuar kërkesën gjithnjë e më të madhe për energji, për të diversifikuar burimet ekzistuese dhe për të bërë tregun më të lëvizshëm. Gjatë 10 viteve të ardhshme, në rrjetet e energjisë do të duhet të bëhet një investim masiv prej rreth 1 000 miliardë euro. BE-ja mund t'u ofrojë ndihmë shteteve të veta anëtare, pasi që është në interesin e tyre të zhvillojnë linja të tensionit të lartë dhe gazsjellësit që i lidhin këto vende me njëra tjetrën, dhe të ruajnë energjinë. Në këtë mënyrë, jo vetëm që nxitet tregtia, por gjithashtu promovohet solidariteti, ku kërkesa ia kalon furnizimit përbrenda kufijve të Evropës. Rrjetet e energjisë elektrike me tension të lartë, të cilat janë krijuar fillimisht për të lidhur centrale të mëdha të energjisë elektrike me zonat fqinje të konsumatorëve, duhet gjithashtu të lidhen me centralet e largëta elektrike, të cilat me ndërprerje prodhojnë energji elektrike nga burimet ripërtëritëse. Së fundi, rrjetet e shpërndarjes duhet të bëjnë të mundur shfrytëzimin e energjisë elektrike në mënyrë më fleksibile, kështu që kulminacioni i kërkesave të mund të menaxhohet më mirë dhe duhet të lejojë mikro-prodhimin individual (për shembull panelet diellore).

Megjithatë, ende nevojitet kohë e gjatë për të marrë lejet e nevojshme të projekteve të rrjetit. Bashkimi Evropian duhet të inkurajojë zhvillimin dhe modernizimin e rrjeteve të energjisë, duke përsheptuar ndërtimin e ‘lidhjeve të humbura’, sidomos në Evropën lindore. Roli i Bashkimit Evropian nuk duhet të jetë vetëm i një koordinuesi të përgjithshëm, pasi që në disa raste, duhet të ndihmojë financiarisht disa projekte që janë thelbësore por që përfshijnë shumë rreze ekonomike për bizneset por edhe për vetë shtetet.



Familjet dhe bizneset evropiane kanë nevojë për energji të sigurt dhe të besueshme.

Konsumatorët janë në qendër të shqetësimeve

Qëllimi përfundimtar i politikave energjetike të BE-së: të sjellë dobi për konsumatorët, qofshin ata individë apo biznese të vogla ose të mëdha. Konsumatorët kanë të drejta dhe duhet të informohen më mirë për këto të drejta, nëse duan të shfrytëzojnë maksimumin e mundësive të ofruara nga tregu i brendshëm i energjisë. Për shembull, ata duhet të kenë mundësi të ndërrojnë furnizuesin, të pranojnë fatura të drejtpërdrejta dhe oferta të krahasueshme, të kuptojnë se prej nga vjen energjia e tyre elektrike dhe të marrin informata lidhur me konsumin e tyre në çdo moment. Teknologjia informative dhe e telekomunikimit përfshijnë një pozitë gjithnjë e më të rëndësishme në sektorin e energjisë, si një mënyrë e përfshirjes më proaktive të konsumatorëve në tregun e energjisë. Vetëm një rregullore mbarë-evropiane vendos të gjithë konsumatorët në pozitë të barabartë dhe u mundëson të përfitojnë nga ekonomitë e mëdha që janë arritur nga ky sektor. Prandaj, Evropa duhet të përfshijë rregulloret e domosdoshme, sidomos kur bëhet fjalë për mbrojtjen e të dhënave nga matësit e gazit dhe energjisë elektrike. Konsumatorët gjithashtu duhet të jenë në gjendje të blejnë aparate shtëpiake që kursejnë energjinë dhe të jenë të informuar lidhur me konsumin e tyre aktual, në mënyrë që të kenë të gjitha informatat e nevojshme para se të blejnë produktin. Bizneset duhet gjithashtu të jenë në gjendje të blejnë energjinë e tyre në mënyrë sa më të sigurt dhe prej atje ku është më e lirë. Vetëm konkurrenca e vërtetë mund të trasojë rrugën për çmime reale, të cilat nuk janë artificialisht të larta ose të ulëta për të inkurajuar investimin në prodhimin e energjisë.

Siguria: çështje me rëndësi për evropianët

Evropianët kanë nevojë të dinë se politika evropiane e energjisë siguron prodhim dhe transport të sigurt të energjisë. Qeveritë e BE-së janë të vetëdijshme për përparësitë e koordinimit në mbarë Evropën ose madje edhe të harmonizimit të standardeve të sigurisë për termocentralet me rëndësi kyçe. Aksidenti i Fukushima në Japoni tregoi se sa është me rëndësi siguria bërthamore. Prandaj, Bashkimi Evropian duhet të caktojë standardet më të larta të sigurisë për centralet bërthamore dhe menaxhimin e mbetjeve bërthamore. Standardet evropiane që mbrojnë popullsinë dhe punëtorët në sektorin bërthamor nga rrezatimi radioaktiv, tani vlejnë në gjithë Evropën. Përfundimisht, Evropa duhet të vazhdojë të garantojë që përdorimi i materialit bërthamor brenda kufijve të saj nuk çon drejt trafikimit të paligjshëm apo përhapjes së armëve bërthamore.

Udhëheqës në teknologjinë me nivel të ulët të karbonit


Do të jetë i domosdoshëm një revolucion teknologjik në Evropë, nëse energjia e saj do të duhet të prodhohet pa emetim të CO₂. Në vitin 2013, Komisioni Evropian propozoi një azhurnim të planit strategjik të BE-së të teknologjisë së energjisë me nivel të ulët të karbonit. Për të adresuar sfidat e reja në tregun global të energjisë, Bashkimi Evropian po vendos prioritetet në kërkim dhe inovacion të energjisë në mënyrë që të sigurojë integrimin e teknologjive me nivel të ulët të karbonit në sistemin e energjisë dhe për të sjellë produkte të reja në treg me kosto efçente.

Qëllimi i kësaj është që t'i mbledhë industrialistët e sektorëve në fjalë të punojnë së bashku, duke përfutur nga mbështetja e Bashkimit Evropian. Disa iniciativa industriale janë duke u fokusuar në prodhimin e energjisë dhe burime të tilla si: biokarburantet, era, energjia diellore, bërthamore, qelizat e karburantit dhe përdorimi i hidrogjenit. Industri të tjera, janë orientuar në drejtim të menaxhimit më të mirë të energjisë në 'qytetet e mençura', robërimin dhe akumulimit të CO₂ nëntokësor dhe rrjetet elektrike të së ardhmes. Synimi është që këto teknologji të reja të jenë të përballueshme dhe profitabile, në mënyrë që të zëvendësohen përfundimisht teknologjitë aktuale dhe të zvogëlohet emetimi i CO₂ në sektorin energjetik të Evropës. Kostoja e madhe financiare, lë të kuptohet se ky qëllim mund të arrihet vetëm përmes një përpjekjeje të koordinuar mbarë-evropiane.

Diplomacia e energjisë

Evropa, tregu rajonal më i madh në botë, duhet të mbrojë interesat e veta në arenën ndërkombëtare, në mënyrë që të garantojë që furnizimi i saj me energji të jetë i sigurt. Kur jeni kaq i madh, por aq i varur nga bota e jashtme, nuk mund të lejoni që punët të marrin vetvetiu ndonjë drejtim — sidomos në një kohë kur gara botërore për burime të energjisë është gjithnjë e më e shprehur. Problemi është se Bashkimi Evropian e ka pasur gjithnjë të vështirë të flasë njëzëri në momentet kur duhet të paraqesë një front të bashkuar, ndaj kjo ka bërë që barra të bie mbi vendet kryesuese të prodhimit dhe konsumit të energjisë. Evropa duhet së pari të sigurohet se fqinjët e vet i shërbejnë interesave të saj të energjisë, jo vetëm për qëllime të transportit të sigurt të energjisë nga furnizuesit e vet të gazit dhe të naftës, por edhe si mënyrë e zgjerimit të tregut të vetë të energjisë. Energjia duhet të jetë pjesë e politikave të jashtme evropiane: ndihma zhvillimore, tregtia dhe marrëveshjet bilaterale të bashkëpunimit. Kjo është gjithashtu një mënyrë e mbështetjes për eksportin e teknologjive më të zhvilluara evropiane.

PREJARDHJA E IMPORTIT TË NAFTËS DHE GAZIT EVROPIAN?



Burimi: Komisioni Evropian.

Vendimmarrja demokratike

Politika energjetike e Evropës është me rëndësi për të gjithë evropianët. Legjislacioni evropian ka ndikim shumë të madh në legjislacionin nacional, sidomos në fushën e energjisë. Parlamenti Evropian (i cili zgjedhet nga evropianët çdo 5 vjet), dhe Këshilli i Ministrave të Bashkimit Evropian (i cili i përfaqëson qeveritë e vendeve anëtare), bashkërisht miratojnë legjislacionin e Evropës për energji, përveç legjislacionit për energji bërthamore dhe tatimin e energjisë, të cilat Këshilli i Ministrave i miraton vet. Qeveritë nacionale janë të përfshira në fazën e parë të hartimit të legjislacionit të BE-së, përmes komiteve të ekspertëve nacionalë. Organizatat profesionale dhe shoqëria civile marrin pjesë në këtë proces transparent, meqenëse mendimi i tyre kërkohet gjatë fazave të ndryshme të konsultimit.

Çfarë po bën Evropa

Fuqizimi i konsumatorëve dhe stimulimi i sektorit të energjisë

Bashkimi Evropian u ofron konsumatorëve të Evropës një nivel të paparë të mbrojtjes: mbrojtjen e konsumatorëve të rrezikuar, rritjen e fuqive rregullore të autoriteteve mbikëqyrëse dhe aftësinë e tyre të imponojnë sanksione dhe qartësim të faturave. Revolucioni i vërtetë qëndron në matësit dhe rrjetin 'inteligjent' për të cilat, Bashkimi Evropian shpreson që do t'i bëjë konsumatorët më proaktiv. Nuk do të jenë vetëm faturat e bazuara në konsumin aktual, por konsumatorët gjithashtu do të jenë në gjendje të marrin informata për konsumin e tyre në çdo moment dhe të marrin hapa për ta përmirësuar atë. Bashkimi Evropian është duke prezantuar masat e nevojshme mbrojtëse për të siguruar respektimin e privatësisë dhe të informatave të mbledhura nga matësit inteligjentë.


Etiketimi i performancës energjetike, i sjellur nga Bashkimi Evropian, do të thotë se blerësit e aparateve elektrike tani janë plotësisht të informuar. Ky lloj i etiketimit tani është duke u vënë edhe në shumë prodhime vendore elektrike, prodhime për zyrë dhe të tjera. Kjo ka inkurajuar prodhuesit që të ofrojnë më shumë produkte që kursejnë energji, duke ndihmuar në zvogëlimin e faturave, pasi që çmimi total i shitjes së një produkti nuk përfshinë vetëm çmimin e blerjes por edhe koston e përdorimit të tij.

Zvogëlimi i faturave të energjisë

Fundi i monopolit në tregjet e energjisë elektrike dhe gazit, nënkupton se të gjithë konsumatorët janë të lirë të zgjedhin furnizuesit e tyre të energjisë. Një studim i ri ka vlerësuar se mbi 13 miliardë euro, d.m.th. 100 euro në vit për një familje mund të kursehen me ndërrimin e furnizuesit të energjisë elektrike dhe gazit. Bizneset ishin të parat që mund të zgjedhnin furnizuesit e tyre të energjisë elektrike dhe gazit. Energjia përbën një proporcion të konsiderueshëm të koston së prodhimit të bizneseve të vogla dhe të mëdha në industrinë kryesore të Evropës. Konkurrenca në mes furnizuesve të energjisë ka zgjeruar ofertën, ka përmirësuar cilësinë e përgjithshme të shërbimit dhe ka mbajtur çmimet sa më të ulta të mundshme.

BE-ja ka parashikuar themelimin e organeve të reja nacionale në secilin vend të BE-së, të njohura si rregullatorë të energjisë, për të siguruar konkurrencë të drejtë. Detyra e tyre është të mbikëqyrin sistemin dhe të sigurojnë që kompanitë e energjisë t'i ndjekin rregullat. Ato kanë fuqi gjithëpërfshirëse për të dënuar praktikën kundër-konkurrese dhe për t'u ndihmuar konsumatorëve të bëjnë zgjedhjet më të mira. Rregullatorët caktojnë tarifat e transportit të energjisë sa më drejtë që është e mundur, në mënyrë që operatorët e rrjeteve të pranojnë paga adekuate dhe të inkurajohen për të investuar, pa ndonjë rritje të madhe në faturat përfundimtare të konsumatorëve. Çmimet e energjisë nuk do të zvogëlohen domosdoshmërisht, mirëpo, në njëfarë mase ato varen nga çmimet botërore të naftës, të cilat është e pamundur të kontrollohen. Mënyra e vetme reale për të zvogëluar faturën tuaj të energjisë është zvogëlimi i konsumit. Nëse qëllimet evropiane të kursimit të energjisë arrihen deri në vitin 2020, kjo do të thotë një kursim vjetor prej 1 000 euro për çdo familje në Evropë.

Etiketimi i energjisë ju ofron informatat e nevojshme.



Sigurimi i furnizimit me energji për Evropë

Reduktimet e rrymës tani janë të rralla në Evropë, kjo në një farë mase ndodh për shkak të bashkëpunimit mes operatorëve të rrjeteve, të vëna në lëvizje nga Bashkimi Evropian. Megjithatë, 67 % e gazit të Evropës importohet në disa raste edhe nga vende të largëta . Një rënie e furnizimit për shkaqe mbi të cilat nuk mund të ushtrohet kontroll, mund të ketë pasoja serioze. Në rast të mungesave, Bashkimi Evropian ka një mekanizëm të plotë të solidaritetit, përmes të cilit mund të arrihet në rezervat e naftës dhe gazit. Megjithatë, parandalimi është më i mirë se kurimi: BE-ja ka themeluar observatorin e tregut të energjisë dhe madje ka futur një mekanizëm të paralajmërimit të hershëm me Rusinë si dhe me vendet tjera kryesore të furnizimit dhe tranzite.

Në tetor 2014, Komisioni publikoi një raport mbi elasticitetin e sistemit evropian të gazit. Raporti vlerëson ndikimin e ndërprerjeve të mundshme të furnizimit me gaz në vende të ndryshme evropiane. Rekomandimi kryesor është se vendet e BE duhet të bashkëpunojnë dhe të lejojnë forcat e tregut të funksionojnë aty ku është e mundur. Kjo qasje bashkëpunuese mund ta zvogëlojë ndjeshëm ndikimin e ndërprerjes së gazit në vendet më të prekura.

Marrëveshja e 'Pakos së Dimrit' midis Ukrainës dhe Rusisë

Në fund të tetorit të vitit 2014, u arrit marrëveshja prej 4.6 miliard dollarësh midis Ukrainës dhe Rusisë, me Komisionin Evropian në rolin e ndërmjetësuesit. Rezultati duhet të sigurojë që ukrainasit (dhe, në fund të fundit, evropianët) të kenë qasje në ngrohje të mjaftueshme në dimrin e vitit 2014/2015.

Korniza 2030 për klimën dhe energjinë

Në bazë të propozimit të Komisionit Evropian, liderët e BE kanë rënë dakord në tetor të vitit 2014 për një kornizë të re të BE-së për klimën dhe energjinë deri në vitin 2030. Korniza përfshin caqet e detyrueshme të BE-së për të zvogëluar emetimet e brendshme të gazit serrë për të paktën 40% krahasuar me nivelet e vitit 1990 dhe për të rritur përdorimin e energjisë së rinovueshme për të paktën 27% të konsumit total të energjisë deri në vitin 2030. Ajo gjithashtu përmban ambicie të vazhduara për politikën e efikasitetit të energjisë, një sistem i ri i qeverisjes dhe një sërë treguesish të ri për të siguruar furnizim me energji të sigurtë, konkurruese dhe të qëndrueshme.

Stimulimi i sektorit energjetik

Konkurrenca mes operatorëve të energjisë elektrike dhe gazit ka tundur sektorin e energjisë. Janë shfaqur profesione të reja (tregtarë, konsulentë, auditorë) dhe sektori gjithnjë e më shumë bazohet në teknologjitë e informimit dhe të komunikimit. Operatorë të rinj kanë hyrë në tregjet nacionale dhe shumë prej tyre tani kanë një dimension evropian. Fitimi i klientëve të rinj, kërkon inovacion për të krijuar produkte të reja, me çmime konkurruese, dhe në këtë mënyrë edhe efikasitet më të madh. Bashkimi Evropian ka përfshirë stimulim dhe masa prioritare për të promovuar burime të reja të energjisë në prodhimin e energjisë elektrike, në biokarburantet dhe prodhimin e ngrohjes, madje edhe kombinimin e prodhimit të energjisë elektrike dhe ngrohjes.



Ndarja më e madhe e energjisë në mes të vendeve të Evropës zvogëlon rreziqet nga mungesa e gazit dhe ndërprerjet e rrymës.

Lulëzimi i energjisë së ripërtërishme

Evropa i ka caktuar vetës një synim që 20% e energjisë së konsumuar në Bashkimin Evropian në vitin 2020 duhet të vijë nga burimet e ripërtërishme (dhe të paktën 27% deri në vitin 2030). Promovimi i këtij objektivi në gjithë Evropën ka sjellë si rrjedhojë një rritje të ndjeshme të kapacitetit prodhues të burimeve të energjisë së ripërtërishme. Në vitin 2011 janë instaluar mbi 100 gigavat të paneleve diellore në të gjithë botën, 70% prej tyre në BE. Prodhimi i energjisë së ripërtërishme në BE kontribuon në uljen e importeve të karburantit fosil të barabartë me rreth 400 miliard € çdo vit.

Zgjerimi i tregut të energjisë së ripërtërishme në Evropë e ka zvogëluar ndjeshëm koston e teknologjive të energjisë së ripërtërishme: për shembull kostoja e paneleve diellore ka rënë për 70% gjatë 7 viteve të fundit. Energjia e ripërtërishme është gjithashtu pjesë e sektorit në rritje të teknologjisë "së gjelbër" e cila punëson gjithëherë më shumë njerëz në Evropë. Në vitin 2011, 1.2 milion njerëz kishin vende punë në energjinë e ripërtërishme. Deri në vitin 2020, sektori i energjisë së ripërtërishme dhe eficienta e energjisë pritet të punësojë mbi 4 milion njerëz në të gjithë BE-në.

Energjia e ripërtërishme është në qendër të strategjisë afatgjate të energjisë së Evropës për shkak se ndihmon për të zvogëluar emetimin e gazit dhe zvogëlon importin e energjisë në Evropë, duke e bërë Evropën më të pavarur. Ky sektor ekonomik në lulëzim, tregon se Evropa është duke prirë rrugën në teknologji të reja të energjisë duke iu siguruar vendeve të BE-së dhe rajoneve të tyre vende të reja pune "të gjelbra" dhe eksporte me vlerë të lartë.

Eficienta e energjisë: një treg premtues

Investimet në eficientë më të madhe të energjisë po stimulojnë zhvillimin. Izolimi i shtëpive, instalimi i pajisjeve të reja për kursim të energjisë, renovimi i ndërtesave dhe kryerja e inspektimeve: të gjithë këto stimulojnë aktivitetin ekonomik. 2 milionë vende pune mund të krijohen deri në vitin 2020, nëse arrihen objektivat e kursimit të energjisë në Evropë. Me një investim vjetor prej 24 miliardë € në izolim, menaxhim të energjisë dhe sisteme të kontrollit, për shembull, fatura e përgjithshme evropiane e energjisë nga tani deri në vitin 2020 mund të zvogëlohet për afërsisht 38 miliardë euro.

BE-ja i ka vënë synim vetës që të gjitha ndërtimet e reja të jenë 'praktikisht me zero energji' deri në fund të dekadës, e cila do të zvogëlojë në mënyrë të konsiderueshme konsumin e energjisë dhe faturat e energjisë. Përdorimi i energjisë së ripërtërishme do të përmbushë nevojat e ulëta të energjisë të këtyre ndërtesave, duke zvogëluar emetimin.

Direktiva e performancës së energjisë së ndërtesave kërkon nga vendet e BE-së të krijojnë një sistem të certifikatave të performancës së energjisë për ndërtesa, përfshirë edhe rekomandimet për eficientë më të lartë të energjisë. Këto etiketa të ndërtimit në përgjithësi ndjekin skemën 'A deri G' të ngjashme me etiketimet e energjisë të BE-së për pajisje të tilla si frigoriferët, 'A', si klasa më e mirë e energjisë. Certifikatat e performancës së energjisë i japin informacione konsumatorëve se sa të larta do të jenë faturat e tyre të energjisë, duke i lejuar ata t'i krahasojnë ofertat dhe për të negociuar më mirë çmimet e qirasë. Është dëshmuar se përmirësimi i eficientës së energjisë për një shkallë (për shembull nga G në F), rrit çmimin e një shtëpie ose banese për të paktën 4 %.

Arritja e synimeve të Evropës për kursim të energjisë mund të krijojë 2 milionë vende pune deri në vitin 2020.



Logoja "Ylli i Energjisë" ndihmon konsumatorët të gjejnë pajisje me efikasitet të lartë të energjisë.



Për më tepër, një rritje e normës së rinovimit të ndërtesave do të kontribuojë fuqishëm në krijimin e vendeve të punës dhe konkurrencës në sektorët e ndërtimit dhe shërbimeve të energjisë. Renovimi i ndërtesave ekzistuese gjithashtu ofron një mundësi të rëndësishme për të stimuluar inovacionin.

Tani e tutje, furnizuesit e energjisë duhet t'i ofrojnë kursimin e energjisë klientëve të tyre. Modeli i biznesit të kompanisë së shërbimit të energjisë duhet të shtrihet në të gjithë Evropën. Kompanitë e këtij lloji janë përgjegjëse për furnizimin e shërbimeve të energjisë (ndriçim, ngrohje, ajër të kondicionuar, furnizimin me energji elektrike), me kusht që ata të investojnë në pajisje me performancë të lartë dhe të korrrin shpërblime nga kursimi i energjisë që ata arrijnë.

BE-ja është duke e ulë konsumin e energjisë përmes kërkesave të eko-dizajnit për një numër të madh të pajisjeve duke përfshirë televizorët, frigoriferët, enëlarëset, lavatriçet, freskoret, ngrirësit, llampat etj. Ndryshimi më radikal dhe i dukshëm ka qenë zëvendësimi në shkallë të lartë, i llampave konvencionale me poçat që kursejnë energji, të cilat shfrytëzojnë deri në pesë herë më pak energji.

Përveç etiketës së energjisë, shenja "Ylli i Energjisë" të cilën e shihni në pajisjet e zyrave tuaja është një provë e dukshme se Bashkimi Evropian po inkurajon shitjen e produkteve që kanë efikasitet energjetik. Qysh nga viti 2001, sipas marrëveshjes me SHBA-në, ka qenë e mundur të shfaqet efikasiteti energjetik i produkteve (kompjuterë, fotokopjues, shtypës, monitorë) përmes etiketës. Kjo informatë u ofron autoriteteve publike një udhëzim të vlefshëm kur bëjnë blerje të mëdha.

Rritja e efikasitetit të energjisë me anë të veprimeve të kërkimit dhe novacionit

Intervistë me Patrick Lambert, Drejtor i Agjencisë Ekzekutive për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (EASME).

Çfarë bën agjencia juaj në fushën e energjisë?

P.L.: Që nga janari i 2014-s, ne jemi përgjegjës për implementimin e thirrjeve për efikasitet të energjisë në kuadër të programit "Horizon 2020" (2014-20), që është pasardhës i programit kornizë për hulumtim dhe zhvillim. Ne do të promovojmë dhe mbështesim projekte përgjatë ciklit të plotë të hulumtimit dhe novacionit, duke përfshirë aktivitetet e ndërmarrja në treg për lehtësimin e zbatimit të politikave, duke rritur nivelet e shkathtësive dhe mobilizimin e investimeve në efikasitetin e energjisë. Gjithashtu do të vazhdojmë të menaxhojmë projekte të mbështetura në kuadër të programit energji inteligjente për Evropën (2007-13), për të nxitur efikasitetin e energjisë dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtërishme. Aktivitetet tona të komunikimit arrijnë kulminacionin çdo vit gjatë Javës së Energjisë së Qëndrueshme të BE-së (EUSEW).

A mund vërtet të ndryshohen qëndrimet për një javë?

P.L.: Gjatë asaj jave u mbajtën disa qindra evenimente në gjithë Bashkimin Evropian, duke përfshirë 100 ose më shumë në Bruksel. Ne duam t'i bëjmë evropianët dhe bizneset më të vetëdijshëm dhe të krijojmë efektin e 'topit të dëborës' (që rritet në shpejtësi të madhe), duke inkurajuar ata të kopjojnë projektet dhe praktikatat më të mira në gjithë Evropën. Çmimet tona të qëndrueshme vjetore të Energjisë janë provë për këtë, si dhe një stimulim shtesë për aktorët.

A nuk është i mjaftueshëm vet legjislati i Evropës?

P.L.: Miratimi i ligjeve është i rëndësishëm, mirëpo veprimet janë të nevojshme edhe në terren, për të siguruar se ato bëhen realitet në jetën e njerëzve. Për shembull, nuk do të jetë e mundur që legjislati evropian për performancën energjetike të ndërtesave të vihet në praktikë, nëse aktorët, duke përfshirë konsumatorët nuk janë të informuar dhe aftësuar në mënyrë adekuate për këtë.

Luftimi i ndryshimeve klimatike

Në bisedimet ndërkombëtare lidhur me klimën, BE-ja është përkushtuar për zvogëlimin e emetimit të gazrave serrë për 20% nga niveli i vitit 1990 deri në vitin 2020 dhe nën rrethana të caktuara rritjen e kësaj përqindjeje në 85%, madje edhe në 95% deri në vitin 2050. Pjesa më e madhe e këtij zvogëlimi do të duhet të vijë nga sektori i energjisë, meqenëse ky sektor përbën 80% të emetimeve të gazrave serrë në Bashkimin Evropian. Nëse Evropa menaxhon të arrijë synimet me shkallën e tanishme, atëherë do ta tejkalojë qëllimin e vet aktual për zvogëlim deri në 20% të emetimit të gazrave serrë dhe të arrijë zvogëlim prej 25% deri në vitin 2020.

Në implementimin e politikave të BE-së për energjinë dhe klimën janë përfshirë të gjitha nivelet e hartimit të politikës, qofshin ato lokale, rajonale, nacionale ose evropiane. Për shembull, Bashkimi Evropian ka lansuar Iniciativën e Paktit të Kryetarëve Komunalë në vitin 2009. Qytezat dhe qytetet nënshkruese morën përsipër të tejkalojnë objektivat evropiane. Aktualisht janë 4000 nënshkruer, të cilët përfaqësojnë më se 160 milionë banorë dhe ofrojnë një potencial të zvogëlimit të CO2 prej 164 milionë tonë, ekuivalente me të gjitha emetimet së bashku të Hungarisë, Suedisë dhe Portugalisë.

Pozita e Evropës në skenën botërore

Bashkimi Evropian ka themeluar një dialog të përhershëm mbi çështjet e energjisë me furnizuesit e vet kryesorë — Norvegjinë, Rusinë, Shtetet e Gjirit dhe OPEC-un — dhe me vende të tjera ose rajone që luajnë një rol të rëndësishëm në skenën botërore të energjisë përkatësisht Brazili, Kina, India, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Afrika dhe Mesdheu. BE-ja ka nisur disa programe për bashkëpunim dhe ndihmë në fushën e energjisë në gjithë botën. Bashkëpunon në mënyrë aktive me organizatat si Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë, Agjencia Ndërkombëtare për Energji Bërthamore dhe Forumi Ndërkombëtar i Energjisë. Ka nënshkruar nismën 'Energjia e Qëndrueshme për të Gjithë', e cila është nisur në vitin 2011 nga OKB, për t'u ndihmuar 500 milionë njerëzve në shtetet në zhvillim të kenë qasje në energjinë e qëndrueshme deri në vitin 2030. Më afër kufijve të vet, Bashkimi Evropian ka nënshkruar një traktat të komunitetit të energjisë, në mënyrë që të integrojë në mënyrë progresive tregjet e Evropës juglindore, Moldavisë dhe Ukrainës në bazë të rregullave të BE-së mbi energjinë, konkurrencën dhe ato mjedisore. Energjia është gjithashtu një element kyç i politikës së BE-së për fqinjësi me vendet në jug dhe lindje të Evropës, me theks të veçantë në efikasitetin e energjisë dhe promovimin e burimeve të energjisë së ripërtërishme.



Puna e filluar

2020 e më pas: ndërtimi i Unionit të Energjisë

Kudo në botë, të gjithë duhet të pajtohemi me qasjen gjithnjë e më të vështirësuar në burimet minerale të planetit. Nafta do të jetë shumë më e shtrenjtë dhe akoma më e vështirë për tu nxjerrë. Ndërsa edhe pse mund të ekzistojnë rezervat e reja të naftës dhe gazit nxjerrja e tyre përballet me shumë kufizime mjedisore. Me zvogëlimin e përmbajtjes së mineraleve në miniera, do të jetë e nevojshme një sasi gjithnjë e më e madhe e energjisë për të nxjerrë mineralet. Prandaj, qasja në burime të energjisë vazhdimisht do t'i nënshtrohet aspekteve gjeopolitike. Kjo për Evropën nënkupton të fillohet së menduari sa më parë rreth sigurisë së furnizimit me energji.

Prandaj, BE ka investuar mjaft shumë në vitet e fundit në diversifikimin e furnizimeve të energjisë dhe rrugëve të energjisë. Një projekt i tillë është korridori jugor i gazit, i cili do duhej t'i siguronte Evropës qasje në burimet e konsiderueshme të gazit në rajonin e detit Kaspik.

Një politikë stabile afatgjate e energjisë

Evropa po përballet me një sfidë të ndërlikuar: nevojën e sigurimit të qasjes në burimet e importuara të energjisë ndërkaq duke furnizuar energjinë me çmimet më konkurruese dhe duke ruajtur mjedisin sa është e mundur. Në përputhje me angazhimet e veta ndërkombëtare, Bashkimi Evropian tashmë ka hapur rrugën drejt një shoqërie me nivel të ulët të karbonit deri në vitin 2050. 'Udhërrëfytyesi 2050' ka nxitur debatin mbi mënyrën më të mirë për menaxhimin e nevojave gjithnjë e më të mëdha energjetike, duke emetuar sa më pak gazra serrë, me çmim të përballueshëm meqenëse një numër i madh i centraleve elektrike që kanë shërbyer deri më tani, në një periudhë prej 30 deri në 40 vjet do të duhet të zëvendësohen në të ardhmen me centrale të reja, BE-ja duhet t'i joshë investitorët e rinj duke iu siguruar atyre kornizën rregullative të qartë dhe stabile.

BE-ja vazhdon të investojë jashtëzakonisht shumë në diversifikimin e burimeve të saja të energjisë dhe rrugëve të energjisë.





Qytetet e së ardhmes do të jenë me karbon të ulët dhe do të ofrojnë shërbime më të mira për popullsinë e tyre në rritje.

Përmirësimi i sigurisë tonë energjetike

Si përgjigje ndaj krizës politike në Ukrainë dhe duke pasur parasysh rëndësinë e përgjithshme të një furnizimi të qëndrueshëm dhe të bollshëm të energjisë për qytetarët dhe ekonominë e BE-së, Komisioni Evropian paraqiti një Strategji të Sigurisë Energjetike të BE-së në maj të vitit 2014. Objektivi i tij kryesor është të përcaktojë mënyrat e zvogëlimit të varësisë së BE-së në energji dhe për të rritur sigurinë energjetike. Strategjia fokusohet në diversifikimin e burimeve të furnizimit me energji të jashtme, modernizimin e infrastrukturës së energjisë, rritjen e prodhimit të energjisë në BE, kompletimin e tregut të brendshëm të energjisë dhe moderimin e kërkesës për energji. Gjithashtu, siguron koordinim më të mirë të vendimeve ndërmjet politikave kombëtare të energjisë.

Këshillat evropiane të qershorit dhe tetorit të vitit 2014, e mirëpritën strategjinë e Komisionit dhe ranë dakord për lansimin e masave afatshkurtra me qëllim të rritjes së sigurisë së energjisë në BE në prag të dimrit të ardhshëm

Strategjia afatgjatë: Korniza e vitit 2030

Nëse BE-ja do të lëvizë drejt një shoqërie me karbon të ulët, asaj i duhet një vizion i qartë për një afat të gjatë. Këshilli i Evropës miratoi propozimin e Komisionit mbi objektivat e klimës dhe energjisë për vitin 2030. Qëllimi i kësaj strategjie afatgjatë është rritja e sigurisë për investitorët, sidomos për projektet afatgjate të infrastrukturës, që t'iu japë udhëzime qeverive të BE-së për përgatitjen e politikave kombëtare dhe të ndihmojë BE-në që të kontribuojë në mënyrë konstruktive në bisedimet mbi një marrëveshje të re ndërkombëtare mbi klimën në vitin 2015. Gjithashtu, ka për qëllim zvogëlimin e varësisë tonë nga lëndët djegëse fosile të importuara, për ta bërë ekonominë e BE-së me më shumë energji dhe burimeve eficiente (dhe në këtë mënyrë më pak intensive në karbon) dhe për rritjen e investimeve në ekonominë e BE-së, zhvillimin e sektorëve të reja, teknologjive dhe vendeve të punës.

Një politikë më evropiane e energjisë

Këto sfida afatgjata mund të përmbushen vetëm përmes integritimit afatgjatë. Pa dyshim se vendime e ndonjë shteti të BE-së kanë pasoja për të gjithë ne. Modernizimi i sistemit të energjisë dhe zhvillimi i zgjidhjeve të reja teknologjike ngrit çështje të mëdha financiare. Pa bashkëpunim evropian, fondet publike nuk do të jenë në gjendje të kanalizojnë investimet në teknologjinë e të ardhmës, të cilat janë ende të rrezikshme për investitorët kombëtar të vetëm. Në këtë periudhë tranzicioni drejt një bote më ekologjike, vendet e BE-së duhet të dakordohen mbi prioritetet e tyre të energjisë për të koordinuar më mirë punën e tyre në këtë fushë dhe t'i mundësojnë BE-së që të flasë njëzëri me botën e jashtme.

Kursimi i energjisë: një objektiv më ambicioz për 2030

Bazuar në një propozim të Komisionit, në tetor të vitit 2014 Këshilli Evropian miratoi një synim të ri në nivel të BE-së: efienca e energjisë duhet të përmirësohet për të paktën 27% deri në vitin 2030. Ky objektiv do t'i sigurojë Evropës përfitime përmes mundësive të reja për bizneset, faturat e përballeshme të energjisë për konsumatorët, rritjen e sigurisë së energjisë me një zvogëlim të ndjeshëm të importeve të gazit natyror dhe një ndikim pozitiv në mjedis. Synimi i propozuar bazohet në arritjet ekzistuese: ndërtesat e reja përdorin gjysmën e energjisë në krahasim me vitet 1980 dhe industria shfrytëzon rreth 19% më pak energji intensive se sa në vitin 2001.

Në vitet e ardhshme, energjia do të vazhdojë të qëndrojë lart në agjendën evropiane. Këshilli i Evropës në veçanti, ka theksuar rëndësinë e eficiencës së energjisë dhe rritjes së prodhimit vendor. Gjithashtu, ka theksuar nevojën për të bërë tregun evropian të energjisë plotësisht funksional dhe të ndërlidhur, bazuar në qasjen rajonale. Kjo do të bëhet duke rritur transparencën në tregun e gazit, duke korrigjuar mangësitë në infrastrukturë, në mënyrë që t'i japë fund izolimit të vendeve të BE-së nga rrjetet e gazit dhe energjisë elektrike evropiane.

Thënë shkurt, një politikë e vërtetë e përbashkët evropiane e energjisë është e vetmja zgjidhje e qëndrueshme për të ardhmen.

Lexime shtesë

LEGJISLACIONI EVROPIAN PËR ENERGJI

► **Përmbledhje e legjislacionit të BE-së:** http://europa.eu/legislation_summaries/energy/index_en.htm

STATISTIKAT EVROPIANE TË ENERGJISË

► **Trendet e energjisë deri në vitin 2050:** <http://ec.europa.eu/energy/en/statistics/energy-trends-2050>

STRATEGJIA EVROPIANE E ENERGJISË

► **Strategjia 2020 / 2030 / 2050:** <http://ec.europa.eu/energy/en/topics/energy-strategy>

POLITIKA EVROPIANE E ENERGJISË

► **Komisioni Evropian – Drejtorja e Përgjithshme për Energji:** http://ec.europa.eu/energy/index_en.htm

